



Shtator 2019 - Mars 2020

Projekti “Statistika të Forta Vendore Shqiptare”, SALSTAT është pjesë e projektit “Bashki të Forta” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për një periudhë katërvjeçare. “Bashki të Forta” punon për zhvillimin e qeverisjes vendore dhe decentralizimin në Shqipëri.

Qëllimi i projektit SALSTAT është të përkrahë INSTAT-in për të ndërtuar dhe forcuar sistemin statistikor në Shqipëri, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të të dhënave statistikore, duke u mundësuar administratës së bashkive që të ofrojnë informacion statistikor të besueshëm, si dhe të krijojnë komponentët kyçë të regjistrave bazë për qëllime specifike administrative dhe statistikore, veçanërisht në nivel rajonal dhe vendor.

Konferenca për prezantimin e projektit SALSTAT u zhvillua më 15 Maj 2018, me praninë e Drejtores së Përgjithshme, Znj. Delina Ibrahimaj dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Federale të Statistikave në Zvicër, Z. Georges Simon Ulrich.

Përmbajtja:

- Treguesit afatshkurtër
- Prezantimi i Vjetarit Statistikor Rajonal “SALSTAT”
- Regjistri statistikor i ndërtesave dhe banesave
- Trajnime me stafin e INSTAT-it dhe bashkitë
- Trajnime me Bashkitë dhe Zyrat Rajonale Statistikore



Treguesit afatshkurtër

Projekti SALSTAT së bashku me INSTAT kanë për qëllim të ofrojnë të dhëna statistikore në nivel rajonal dhe vendor, duke përmirësuar treguesit kyçë aktualë dhe duke ofruar tregues të rinj për një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Një pjesë e punës ka qenë rishikimi i Vjetarit Rajonal të botuar nga INSTAT në nivel rajonal dhe vendor, me tregues të rinj e të përmirësuar.

Kjo punë ka përmirësuar më tej disponueshmërinë dhe shpërndarjen e treguesve statistikore vendorë dhe rajonale, në veçanti për periudhën e viteve 2019-2022. Gjithashtu, është identifikuar një listë të treguesve afatshkurtër nga një grup pune i brendshëm i INSTAT-it.

Kjo përbëri bazën për rishikimin e Vjetarit Statistikor Rajonal. Qëllimi i botimit është përfshirja e më shumë treguesve për qarqet dhe bashkitë, duke përfshirë edhe numrin e të dhënave statistikore.

Prezantimi i Vjetarit Statistikor Rajonal

Më 22 Nëntor u organizua një aktivitet në ambientet e Hotel Tiranës në të cilin u prezantua botimi i Vjetarit Rajonal për vitin 2019, me pjesëmarrjen e përfaqësueses së SDC-së, Znj. Chantal Nicod, Drejtuese e Departamentit të Qeverisjes dhe Shëndetësisë, Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, përfaqësueses së INSTAT-it, Znj. Elsa Dhuli, Menaxherit të Projektit SALSTAT, Z. Martin Teichgraeber, Z. Werner Haug, specialist i ZFS-së, Z. Aldrin Dalipi, Kryetari i Këshillit të Qarkut të Tiranës dhe Znj. Adelina Farrici, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore, si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive dhe institucioneve të tjera. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan:

- Gjetjet kryesore të Vjetarit Statistikor Rajonal
- Parimet dhe risitë kryesore të Vjetarit Rajonal
- Të dhënat për Vjetarin Statistikor Rajonal në platformën GIS në internet (<https://instatgis.gov.al>)



Botimi është i disponueshëm edhe në gjuhën shqipe në faqen zyrtare të INSTAT:

<http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2019/vjetari-statistikor-rajonal-2019/>

Aktualisht, po punojmë së bashku me INSTAT për përmirësimin e anketimeve për familjet, statistikat e buxhetit dhe mbledhjes së të dhënave (administrative, regjistra dhe anketime), me qëllim shpërndarjen e më shumë treguesve kyçë lidhur me migracionin (e brendshëm/të jashtëm) dhe në nivel rajonal (12 Qarqe) dhe në nivel vendor (61 Bashki).

Regjistri statistikor i ndërtesave dhe banesave

Projekti ka filluar të zhvillojë një koncept për një regjistrë statistikor të ndërtesave dhe banesave. Ideja e regjistrit është që të regjistrojë të gjitha ndërtesat dhe banesat, përdorimin e tyre dhe banorët e tyre.

Për këtë arsye, SALSTAT po kryen një vlerësim të hollësishëm për variablat ekzistuese dhe disa variabla shtesë që nevojiten për krijimin e një regjistri statistikor të ndërtesave dhe banesave nga të gjitha burimet përkatëse (për shembull Censi, Sistemi Shqiptar i Adresave, Regjistri i Gjendjes Civile, dhe regjistri për lejet e reja të ndërimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, dhe të dhënat e disponueshme në bashki, etj.). Në bazë të gjetjeve, do të hartohet një propozim për regjistrin statistikor të ndërtesave dhe banesave. Kjo punë është ende në vazhdim dhe rezultatet do të jenë gati në muajt e ardhshëm.



Trajnime me stafin e INSTAT-it dhe bashkitë

Një shtyllë themelore e projektit është rritja e kapaciteteve të bashkive, institucioneve dhe zyrave statistikore rajonale për të përmirësuar dhe ofruar informacion bazë statistikor në nivel vendor dhe rajonal, si dhe angazhimin e tyre nga ana e stafit të INSTAT-it për trajnime të ndryshme specifike, me qëllim përmirësimin e statistikave vendore dhe rajonale.


Trajnime me Bashkitë dhe Zyrat Rajonale Statistikore

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve për bashkitë, do të organizohen trajnime me stafin e bashkive dhe zyrave statistikore rajonale. Qëllimi i trajnimeve është që të mundësojë administratat e bashkive që të përmbushin funksionet dhe detyrat e tyre në mënyrë eficiente dhe efikase, duke ofruar informacion statistikor të besueshëm. Trajnimet do të përqendrohen në këto tema kryesore:

- Njohuri mbi statistikat zyrtare dhe sistemin statistikor Cilësia statistikore (Nivel fillestar)
- Mbledhja e të dhënave dhe Përpunimi statistikor
- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)
- Excel
- Shpërndarja, komunikimi dhe botimi
- Statistikat ekonomike
- Menaxhimi i mbetjeve urbane

Ishte planifikuar që trajnimet për temat e mësipërme do të zhvilloheshin gjatë periudhës Prill-Maj 2020 nga stafi i INSTAT-it në ambientet e këtij të fundit. Por, për shkak të situatës me të cilën po përballlet vendi ynë, me pandeminë botërore të COVID-19, këto trajnime janë shtyrë dhe shpresojmë që të zhvillohen gjatë muajve Qershor-Korrik 2020. Ekipi i SALSTAT ka marrë përsipër organizimin e trajnimeve.

Gjithashtu, stafi i INSTAT është trajnuar për Gjuhën R të Statistikave, trajnim i zhvilluar nga Z. Beat Hulliger, profesor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara FHNW, Zvicër.



FALEMINDERIT NGA EKUPI I SALSTAT!

Instituti i Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: info@instat.gov.al

Telefon: +355 (4) 2233356 / 2233358